



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**V E N D I M**

**Nr. 496, Datë 13.09.2024**

**PËR**

**PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË ZNJ. {...} DHE CAKTIMIN NË POZICIONIN E NDIHMËSIT LIGJOR NË NJËSINË E SHËRBIMIT LIGJOR PRANË GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 13.09.2024, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e çështjes znj. Gentiana Muçaj dhe pasi shqyrtoi propozimin e ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**V Ë R E N:**

**I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Znj. {...} ushtron detyrën e Ndhmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

1.1 Rezulton se Znj. {...} është emëruar në detyrë si Ndhmës Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me Urdhërin nr. 51 prot., datë 03.06.2015 “Për emërimin e ndihmësit ligjor” të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

2. Ndërkohë, me Vendimin nr. 579 datë 20.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:  
“1. *Ndërprerjen e marrëdhënies së punës të ndihmëses ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, znj. {...}.*

2. *Emërimin e përkohshëm të znj. {...}, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.*

3. *Efektet juridike dhe financiare të vendimit fillojnë në datën 01.12.2020....”*

2.1 Aktualisht, Znj. {...}, vijon ta ushtrojë detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me miratimin e vendimit të tij, nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor ose për ndihmës ligjor” ka patur si qëllim përcaktimin e rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror dhe të proporcionalitetit, për zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.1 Kështu, ky vendim rregullon procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore, ndër të tjera edhe për ndihmësat ligjorë në detyrë në gjykatat administrative, si dhe të pasurisë dhe figurës së tyre.

3.2 Vendimi nr. 424/2020, në Kreun IV, pika 10 ka parashikuar se, si objekt verifikimi, ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative i nënshtrohen verifikimit të kushteve dhe kritereve formale të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, përfshirë dhe atij të konfirmimit në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar.

3.3 Ndërsa në Kreun XI, ky vendim ka parashikuar dispozita për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë në detyrë. Konkretisht në pikën 128, seksioni C, i këtij kreu parashikohet se: *“Ndihmësi ligjor në detyrë në gjykatat administrative është subjekt rivlerësimi kalimtar sipas nenit 179/b, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konfirmimi i tij në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar sipas këtij ligji, përbën kusht për pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.*

4. Rezulton se, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 769 datë 31.05.2024, në përfundim të procedurës së verifikimit të subjektit të rivlerësimit kalimtar znj. {...}, ka konkluduar, duke vendosur përfundimisht :

*“Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:*

*a. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*

*b. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;*

*c. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

*Bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, referuar nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur :*

*1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit {...}, ndihmëse ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.*

*2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.*

*3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*

*4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.”.*

4.1 Ky vendim ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar më datë 4.7.2024.

5. Sa sipër, znj. {...}, në respektim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në pikën 130, Seksioni C, Kreu XI, të vendimit të Këshillit nr. 424/2020, ku parashikohet se: “*Ndihmësi ligjor që konfirmohet në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, pika 9, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të tij aktual dhe për të cilin përmbush kriteret*” ka depozituar kërkesë përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmës ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit.

6. Rezulton se kërkesa është depozituar më datë 29.07.2024, protokolluar në Këshill me nr. 3928 akti, në të cilën shprehet interesi nga znj. {...}, për emërim si Ndihmës Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

7. Në kushtet kur, znj. {...} ka shprehur interesin për emërimin në pozicionin e Ndihmësit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Këshilli ka detyrimin të bëjë emërimin në pozicion, në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish civil gjyqësor, pasi të bëjë verifikimin nëse ka plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara nga ligji për këtë pozicion.

8. Pasi kërkesa rezultoi të jetë paraqitur në respektim të afatit të parashikuar në pikën 131, Seksioni C, Kreu XI, të vendimit të Këshillit nr. 424/2020, ku parashikohet se: *“Kërkesa për t’u caktuar në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor paraqitet përpara Këshillit brenda një muaji pas bërjes përfundimtar të vendimit të organeve të rivlerësimit kalimtar. Në këtë rast marrëdhënia e punës së ndihmësit ligjor në gjykatën përkatëse të apelit mbaron në momentin e marrjes së vendimit për kërkesës e paraqitur nga ai sipas kësaj pike”*, në funksion të shqyrtimit të kësaj kërkesë bazuar në pikën 134, Seksioni C, Kreu XI të këtij vendimi, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit caktoi si relator, njërin prej anëtarëve të saj, znj. Gentiana Muçaj.

9. Në respektim të detyrimeve të përcaktuara në pikën 135, Seksioni C, Kreu XI, të Vendimit 424/2020 të Këshillit, relatorja kreu procedurën e verifikimit në lidhje me përmbushjen e kushteve/kritereve të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si dhe të kritereve të veçanta për pozicionin e kërkuar, rezultatet e së cilës do të pasqyrohen më poshtë.

9.1 Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit në mbledhjen e datës 09.09.2024, bazuar në pikën 135, Seksioni C, Kreu XI të vendimit 424/2020, pasi kontrolloi plotësinë e verifikimeve të kryera nga relatori, duke konsideruar se procedura për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kriteve të përgjithshme të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, si dhe të kritereve të veçanta për pozicionin e kërkuar është e plotë, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit, mbi pranimin e znj. {...} në shërbimin civil gjyqësor dhe caktimin e saj në pozicionin e kërkuar.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT**

10. Sikurse u parshtrua më lart, në Kreun XI, vendimi 424/2020 ka parashikuar dispozita për kancelarët, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë në detyrë. Konkretisht në pikën 129, seksioni C, i këtij kreu, parashikohet se: *“Ndihmësit ligjorë në detyrë në gjykatat administrative, përveç kur marrëdhënia e punës përfundon për arsye ligjore, ose si rezultat i procesit të rivlerësimit, në përputhje me Ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në detyrë, në përputhje me parashikimet ligjore, përpara hyrjes në fuqi të Ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si më poshtë: a) ndihmësit ligjorë në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit vazhdojnë të qëndrojnë përkohësisht në të njëjtën detyrë”*.

10.1 Pra efektet juridike të filluara më datë 10.06.2015, ku Znj. {...} është emëruar në detyrë si Ndihmës Ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me Urdhërin nr. 163

prot., datë 05.06.2015 “Për emërimin e ndihmësit ligjor” të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, zgjasin deri në përfundim të procedurës së verifikimit.

11. Bazuar në rezultatet e vendimmarrjes së Komisionit të Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 769 datë 31.05.2024, në përfundim të procedurës së verifikimit të subjektit të rivlerësimit kalimtar znj. {...} ka konkluduar, duke vendosur përfundimisht mbi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

11.1 Ky vendim ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar më datë 4.7.2024, pra ka statusin e vendimit përfundimtar.

12. Ndërkohë, kur verifikimi i pasurisë dhe figurës, konsiderohet i përmbushur, referuar Vendimit nr. 769 datë 31.05.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbi konfirmimin në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me parashikimet e dispozitave ligjore të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se znj. {...} i është nënshtruar tashmë verifikimit të kushtit formal të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, proces të cilin e ka kaluar me sukses dhe duhet të pranohet në shërbimin civil gjyqësor.

13. Këshilli vlerëson se një ndër përgjegjësitë e tij të ngarkuara nga Kushtetuta e Republikës është dhe ajo lidhur me drejtimin dhe kujdesjen e mbarëvajtjes së punës në administratën e gjykatave, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “d”, dhe “ë”, ku theksohet se: “1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: ... d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.”.

14. Në Ligjin për Pushtetin Gjyqësor, që në nenin 1, pika 1, shkronja “d”<sup>1</sup> është parashikuar se një ndër qëllimet e tij kryesore është edhe përcaktimi i rregullave lidhur me statusin e nëpunësve civilë gjyqësor. Në nenet 50 - 63, ky ligj i dedikohet pikërisht statusit të nëpunësve civilë gjyqësor në gjykatë. Në këto dispozita<sup>2</sup>, parashikohet se organi kompetent për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, për kategoritë kancelar, këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe ndihmës ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit është Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kjo kompetencë

---

<sup>1</sup> Neni 1, pika 1, shkronja “d” e Ligjit nr. 98/2016 parashikon se: “1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve të përgjithshme dhe i rregullave në lidhje me: ... d) statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë.”

<sup>2</sup> Neni 50 i Ligjit nr. 98/2016, i ndryshuar, parashikon se: “1. Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë janë: a) kancelari; b) këshilltari ligjor në Gjykatën e Lartë; c) ndihmësi ligjor në gjykatën e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit; ç) kryesekretari; d) sekretari gjyqësor; dh) nëpunësi i financës dhe buxhetit; e) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit, burimeve njerëzore, teknologjisë së informacionit, arkivit dhe marrëdhëniet me publikun, me jashtë ose me median. 2. Statusi i nëpunësve civilë gjyqësorë rregullohet nga ky ligj”.

është e sanksionuar edhe në nenin 59 të këtij ligji, ku theksohet se: “1. Organi kompetent për emërimin e kancelarit, këshilltarit dhe ndihmësit ligjor është Këshilli i Lartë Gjyqësor.”.

15. Lidhur me kriteret e përgjithshme që duhet të plotësohen për *ndihmës ligjor*, Ligji Për Pushtetin Gjyqësor parashikon si të tilla, të njëjtat kriteret e përgjithshme që duhet për pranimin në shërbimit civil, të parashikuar në legjislacionin për nëpunësin civil, ndërkohë që si kriteret të veçanta për këtë kategori, kategorinë e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatën e apelit, ligji ka parashikuar në pikën 2, të nenit 56 të tij, që janë: “2. Për pozicionin e ndihmësit ligjor në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, kandidatët duhet të përmbushin këto kriteret të veçanta: a) të jenë diplomuar në drejtësi në nivelin “Master shkencor”, të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë; b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet, si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barazvlefshëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare”.

15.1 Sa sipër, lidhur me plotësimin e kriterëve të pranimit në shërbimit civil gjyqësor të znj. {...}, konstatohet fakti se ajo i përmbush të dyja këto kriteret, bazuar në të dhënat që disponon Këshilli në dosjen personale të saj, pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

16. Në kushtet kur rezulton se znj. {...} ka depozituar kërkesë më datë 29.07.2024, protokolluar në Këshill me nr. 3928 akti, në të cilën shprehet interesi, për emërim si Ndhmës Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Këshilli ka detyrimin të bëjë emërimin në pozicion, në rastin e pasjes së vendit të lirë për këtë kategori nëpunësish civil gjyqësor, pasi kreu verifikimin se ajo i përmbush të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara nga ligji për këtë pozicion.

17. Për këtë qëllim, u verifikua organika e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me organizimin dhe numrin e ndihmësave ligjorë pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor. Neni 42 i Ligjit për Pushtetin Gjyqësor parashikon, organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Shërbimit Ligjor pranë gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, njësi e cila përbëhet nga ndihmësa ligjorë, e krijuar me Vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

17.1 Nga informacioni i përcjellë në rrugë elektronike më datë 30.07.2024, nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, referuar të dhënave mbi Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se njësia është e përbërë nga 32 (tridhjetë e dy) pozicione sipas strukturës organizative, 20 (njëzet) pozicione sipas organikës në fakt, përfshirë dhe znj. {...} dhe 12 (dymbëdhjetë) pozicione vakante. Pra konstatohet se ka pozicione të lira në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në dispozicion të kandidatëve për ndihmës ligjor.

18. Lidhur me emërimin e ndihmësit ligjor, referuar parashikimeve të Vendimit nr. 424/2020, në pikën 139 të tij, thuhet se : *“Në rast se përpara Këshillit, në të njëjtën kohë, janë për shqyrtim disa kërkesa për caktimin në të njëjtin pozicion të të njëjtës gjykatë, nga kategoria e ndihmësve ligjorë të konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, ato shqyrtohen nga i njëjti relator. Caktimi në pozicion në këtë rast bëhet mbi bazë konkurrimi. Këshilli zgjedh kandidatin, duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme sipas kësaj radhe: a) renditjen e tyre në testin e aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës, të zhvilluar sipas parashikimeve të Ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; b) çdo njohuri ose përvojë të veçantë të kandidatit, që e bën atë veçanërisht të kualifikuar për vendin e lirë; c) vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose në pozicione drejtuese”*. Kjo procedurë e parashikuar nga ligji mban në konsideratë rastin kur kemi më shumë kandidatë sesa vende vakant të lirë, ndërkohë në rastin konkret, të emërimit të znj. {...}, për sa kohë ushtron funksionin aktualisht në Njësinë e Shërbimit Ligjor në Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, procedura e zgjedhjes e parashikuar nga pika 139, e vendimit të sipërcituar nuk ka vend për t’u zbatuar.

### **III. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI**

19. Sa më sipër, duke konstatuar se znj. {...}, plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, në kushtet kur ajo është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar të organeve të rivlerësimit kalimtar, në përputhje me nenin 165, pika 9, të Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ka të drejtën e caktimit në një pozicion si nëpunës civil gjyqësor në sistemin gjyqësor që i përshtatet më së miri profilit të saj aktual për të cilin përmbush kriteret, si dhe kur aktualisht ushtron funksionin pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Këshilli vlerëson se duhet t’a pranojë në shërbimin civil gjyqësor, për pozicionin e ndihmësit ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për shkak dhe të kushteve dhe nevojave që ka aktualisht gjykata, ku kontributi i ndihmësve ligjor konsiderohet i rëndësishëm.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “d” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, 90, pika 1, shkronja “h” dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 36, 42 pika 1 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, si dhe vendimit nr. 769 datë 31.05.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor

## **V E N D O S I :**

1. Pranimin në shërbimin civil gjyqësor të Znj. {...} dhe caktimin në pozicionin e Ndhmësit Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Efektet e juridike të këtij vendimi, përfshirë dhe ato financiare, fillojnë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
3. Një kopje e vendimit të arsyetuar t'i njoftohet Znj. {...} dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**